MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË TELEGRAFIKE SHQIPTARE (PERFORMANCË)

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në **ATSH Tiranë,** me objekt: *"Për vlerësimin e veprimtarisë së Agjensisë Telegrafike Shqiptare, efiçiensa dhe efektiviteti i saj, për periudhën 1/1/2009 deri 31/12/2011"* dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr.151, datë 30/09/2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 168/6, datë 30/09/2012 dërguar **Z. Gëzim Podgorica, *Drejtor i Përgjithshëm i ATSH,*** krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

Veprimtarinë e saj ATSH e ushtron në bazë të Dekretit të Presidiumit të Kuvendit Popullor, nr. 1960, datë 9/11/1954 "Mbi Agjensinë Telegrafike Shqiptare". Në kushtet e zhvillimeve të reja politike dhe ekonomike të vendit pas viteve 90-të, në bazë të këtj ligji ajo e mbështet veprimtarinë vetëm në një nen e konkretisht në nenin 8 të këtij Dekreti ku përcaktohet se "Agjensia Telegrafike Shqiptare varet nga Këshilli i Ministrave i cili cakton strukturën organizative". Kjo ka sjellë gjendjen që ky institucion të funksionojë deri tani pa ligj të rinovuar dhe të plotë, i cili të krijojë mundësinë e përcaktimit të rregullave të funksionimit dhe organizimit, lidhje organike me ligjet e tjera që rregullojnë veprimtarinë e saj, t'i japë pavarësinë si institucion, të përcaktojë rregullat e bashkëveprimit me institucione të tjera shtetërore e private, kjo në kushtet e ndryshimeve të mëdha politike dhe ekonomike të ndodhura tashmë prej rreth 20 vitesh.

Për sa më sipër:

1. *Duhet miratuar një ligj i ri për veprimtarinë dhe strukturën e ATSH-së*. Këto ndryshime ligjore duhet të adresojnë specifikisht;

1.1 Reformimin strukturor imediat të institucionit, duke punuar vetëm me sektorin jashtë vendit dhe për lajmet jashtë vendit. Rrjedhimisht duke **përgjysmuar strukturën, buxhetin dhe numrin e punonjësve të saj.**

Ky reformim duhet ndërmarrë sa më shpejt, në mënyrë që të përfshihet në buxhetin e ri, me fillimin e vitit 2013.

1.2 Mundësinë e kalimit të ATSH-së si një drejtori e veçantë pranë Televizionit Shqiptar, përsëri duke theksuar përgjysmimin e strukturës dhe

buxhetit të saj të sotëm, për të rritur efiçiensën si dhe drejtimin e saj unikal për prodhimin dhe shpërndarjen e lajmeve jashtë vendit.
Edhe kjo mundësi duhet konsideruar ligjërisht sa më shpejt, në mënyrë që të implementohet me fillimin e vitit 2013.

2. Në zbatim të ligjit të ri, në një perspektivë afatmesme ose afatgjatë, të vlerësohet mundësia e privatizimit të ATSH-së, për të rritur pavarësinë, efiçiensën, cilësinë dhe konkurrueshmërinë e institucionit. Shumica e agjensive simotra në botë zotërohen privatisht ose pjesërisht privatisht.

3. Në zbatim të ligjit të ri, në një perspektivë afatmesme ose afatgjatë, të vlerësohet mundësia e kalimit në një kompani sh.a mediatike me financime të përbashkëta të buxhetit të shtetit dhe shoqërive private, nëpërmjet një marketingu agresiv për sigurimin e burimeve alternative të financimit

4. Në zbatim të ligjit të ri, ATSH duhet të hartojë rregulloren e brendshme, si dhe të hartojë planin strategjik afatmesëm dhe afatgjatë, si edhe planin konkret të veprimeve për realizimin e qëllimeve të saj në rritjen e performancës.

Menjëherë

B. <u>MASA ORGANIZATIVE</u>

ATSH të marrë masa për fuqizimin e saj cilësor si e vetmja media shtetërore duke rritur performancën edhe në paraqitjen e saj vizive (internet, televizion, rrjetet sociale, etj). Konkretisht:

1. ATSH të ngrejë një grup të posaçëm pune, për analizimin e nivelit shumë të ulët të realizimit të të ardhurave, për hartimin e preventivave që lidhen me koston e prodhimit dhe të transmetimit të produktit të saj, për studimin e tregut për nevojën e shërbimeve të ofruara nga ATSH si dhe t`i kushtojë vëmendje menaxhimit financiar në lidhje me objektivat e politikës së programit buxhetor.

Menjëherë

2. ATSH-ja duhet të marrë masa në drejtim të përmirësimit të përformancës të produktit saj për të bërë të mundur që:
a) të sigurojë një përshkrim të besueshëm, gjithëpërfshirës dhe të saktë të ngjarjeve të ditës.
b) të prodhojë informacion lehtësisht të konsumueshëm nga qytetari i thjeshtë,
c) të jetë një forum për shkëmbim komentesh dhe kritikash të grupeve përbërëse dhe më ndikuese të shoqërisë,

d) të prezantojë dhe qartësojë synimet dhe vlerat e shoqërisë,
e) të sigurojë qasje të plotë të ndodhive të ditës, me anë të së cilës i shërben publikut për të qenë i informuar,
f) të shërbejë si një kontrollor mbi qeverinë.

Vazhdimisht

3. ATSH të hartojë standarde në formën e rregulloreve ose manualeve, etj, që të përcaktojë mënyrën e vlerësimit të punonjësve për punimet e tyre, ngarkesën në punë, verifikimin e dhënies së lajmeve në raport me mediat e tjera, të testojë veten dhe cilësinë e shërbimeve të saj nëpërmjet pyetësorëve.

Menjëherë

4. ATSH duhet të përmirësojë teknologjinë, me synimin kryesor rritjen e shpejtësisë në hapjen e faqes në internet, rritjen e shikueshmërisë, rritjen e numrit të lexuesve dhe përdoruesve të saj.

Menjëherë

5. ATSH duhet të intensifikojë marrëdhëniet me institucionet vendase dhe partnerët e huaj për përthithjen e projekteve me qëllim modernizimin e saj, të përdorë të gjitha format e marketingut për rritjen e shitjeve të produkteve dhe të shërbimeve të saj për rritjen e të ardhurave, si dhe të përcaktojë kush ka detyrimin ligjor të ndjekjes dhe zbatimit të kontratave apo marrëveshjeve me partnerët e huaj.

Menjëherë

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Elfrida Taraku Përgjegjës Grupi, Yllka Dede, Alfred Zylfi dhe Arminda Bushi. Më tej u shqyrtua nga Kryeauditues i Departamentit zj. Luljeta Nano, Drejtori i Departamentit z. Ded Trieshi dhe Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë z. Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm z. Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT